



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



DokuFest
Palë ankuese
Prizren

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. nr 2023/122: Ankesa e DokuFest (Palë ankuese)
kundër TV Besa**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 26 gusht 2023 ka pranuar një Ankesë të parashtruar nga Pala ankuese, me pretendimin se në lajmet informuese në datat: 5, 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12 gusht 2023 TV Besa ka transmetuar lajme jo të sakta, jo të verifikuara, ka krijuar keqinformim të opinionit, ka raportuar në mënyrë nxitëse për dhunë, urrejtje, si dhe lajme për prishje të imazhit ndaj organizatës DokuFest, veprime këto në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio vizuale në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore, me datën 12 shtator 2023 i ka dërguar shkresë TV Besës përmes të cilës ka kërkuar sqarim për ankesën e parashtruar.
4. KPM ka pranuar përgjigje nga TV Besa me datën 12 shtator 2023 në të cilën i ka kundërshtuar pretendimet ankimore, mirëpo duke theksuar se: *"Ne si TV Besa jemi gati që komfor ligjeve në kuadër të secilës informatë të japim demant në qoftë se ndonjë nga lajmet tona ka pasur mungesë apo devijim të informatës së saktë."*
5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, përgjigjen e TV Besës, si dhe ka bërë monitorimin e kronikës në fjalë. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 shtator 2023 KPM ka konstatuar se lidhur me pretendimin për nxitje të urrejtjes, nuk është transmetuar ndonjë përmbajtje programore që nxitë urrejtje të caktuar. Lidhur me pretendimin për transmetim të lajmit jo të saktë, në arkivën e deponuar nuk është gjetur ky material. Ndërsa, lidhur me balancimin e lajmit, KPM ka konstatuar se TV Besa nuk i ka ofruar mundësinë për t'u përgjigjur Palës ankuese.

6. Për këtë arsye KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 2 tetor 2023 TV Besës, në të cilin e ka udhëzuar që në afat prej shtatë (7) ditësh, pas pranimit të shkresës, t'ia ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPPM-2016/03.
7. TV Besa me datën 5 tetor 2023 është përgjigjur pas Njoftimit për shkelje, duke theksuar se: *“Sa i përket ankesës së OJQ Dokufest ne brenda afatit të caktuar nga zyra juaj do të kërkojmë demantin e palës ankuese edhe pse konsiderojmë se asnjë nga pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë.”*
8. Për të vërtetuar se TV Besa i ka ofruar të drejtën e reagimit, KPM ka kontaktuar Palën ankuese. Me datën 25 tetor 2023 Pala ankuese ka kthyer përgjigje duke theksuar se: *“Po ju konfirmoj se me datë 7 tetor 2023 na është ofruar e drejta e demantit mirëpo, qëndrimi i Dokufestit është ky nuk ka arsye çka të demantojmë sepse lajmet jo të sakta dhe të pavërteta i ka dhënë TV Besa, ky medium duhet vetë të demantojë publikisht se e ka informuar publikun në mënyrë jo të saktë dhe ka raportuar jo profesionalisht. Prandaj për ne është i rëndësishëm vendimi i KPM-së për të ndaluar gazetarinë jo profesionale dhe manipuluese.”*

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se TV Besa nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPPM-2016/03.
10. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të Departamentit të Monitorimit dhe Analizës të datës 15 shtator 2023 ka konstatuar se lidhur me pretendimin e Palës ankuese se TV Besa ka transmetuar përmbajtje që kanë nxitur urrejtje, nuk është konstatuar se është transmetuar ndonjë përmbajtje programore që nxitë urrejtje të caktuara.
11. KPM, po ashtu, bazuar në Raportin e monitorimit, lidhur me pretendimin e Palës ankuese për pasaktësi të lajmit, në arkivën e deponuar nuk është gjetur material që dëshmon që ka pasur pasaktësi nga TV Besa.
12. Ndërsa, lidhur me balancimin e lajmit, KPM ka konstatuar se TV Besa gjatë raportimit lidhur me organizimin Dokufestit nuk ka paraqitur qëndrimin e Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHMA-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërtshënive politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”
13. KPM, pas këtyre të gjeturave, i ka dërguar Njoftim për shkelje TV Besës me datën 2 tetor 2023, në të cilin e ka njoftuar për shkeljen e gjetur dhe e ka udhëzuar që në afat prej shtatë

(7) ditëve, pas pranimit të letrës, t'i ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Nenin 10, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Me qëllim korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”

14. Pas Njoftimit për shkelje, KPM ka konstatuar se TV Besa për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 i ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, duke i dhënë hapësirë për të demantuar lajmin.
15. Bazuar në përgjigjen e Palës ankuese, KPM ka konstatuar se edhe pas ofrimit të mundësisë për reagim të cilin ia ka ofruar TV Besa, Pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar.
16. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se TV Besa nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Vendim

17. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se TV Besa ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të kronikave në lajmet informuese në datat: 5, 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12 gusht 2023.

E drejta për ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar



15.04.2024
Datë